**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PUKË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr. 47/2 prot:** **Pukë, më 22.01.2025**

**VENDIM**

**Nr. 02 datë 22.01.2025**

**"Per miratimin e dhenies së mandatit të Zj. Leze Ndrek Kolaj "**

Ne zbatim te ligjit nr **139/2015** ''Per Veteqeverisjen Vendore ,neni 49,pika 1,dhe neni 50 pika 2 dhe 3 dhe rregullores së Keshillit Bashkiak Pukë , si dhe në zbatim të shkresës së KQZ me nr.nr.prot.165 date 10.01.2025 , Këshilli i Bashkisë Pukë në mbledhjen e dates **22.01.2025, me propozim të kryetarit të këshillit bashkiak,** pasi shqyrtoi Raportin e Komisonit te mandateve:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë dhenien e mandatit të antares së këshillit zj. Leze Ndrek Kolaj e partisë Social demokrate.
2. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 pika 6 te ligjit 139/2015 date 17.12.2015 " Per vetqeverisjen vendore"
3. Vendimi u shpall me datë 22.01.2025.
   Vota të vlefshme gjithsej 10
   Vota pro 10 vota kunder 0 , vota abstenim 0

SEKRETARI
Hazbi Terbuni

KRYETARI
Gjon **GJOKA**

Adresa:Bashkia Puke,sheshi"Gjergj Kastriot Skenderbeu";e-mail:bashkiapuke@yahoo.com

06.02.25 H. Ter... për ... 

47/4 06.02.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**PREFEKTI I QARKUT SHKODËR**

**Nr.71 /1.prot**

**Shkodër,më 04.02.2025**

**LËNDA:** Mbi vendimin Nr.2, datë 22.01.2025 të Këshillit të Bashkisë Puke.

**KËSHILLIT TE BASHKISE PUKE**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin Nr.107 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 "Për miratimin e rregullores së Brendshme "Për organzimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut" si dhe aneksi 1 "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut", Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 49/1/2/3, neni 54/j, neni 55/3, VKB Puke Nr.52 datë 16.10.2024 "Mbi dorëheqjen e Zj.Klodisa Ded Qeleshi", Shkresës së Sekretarit të Këshillit të Bashkisë Puke Nr.80/4prot datë 23.01.2025 "Dërgojmë vendimet e Këshilli Bashkiak Puke", Shkresës së Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve Nr.7108prot datë.5.10.2023 "Njoftim për vazhdimin e procedurave, për dhënien e mandatit", Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Nr.8 datë 8.01.2025 "Për plotësimin e vakancës në Këshillin Bashkiak Pukë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate", Zj.Leze Ndrek Kolaj", Raportit të komisionit të mandateve nr.1 datë 21.01.2025, U njoh me ***VKB Pukë Nr.2 datë 22.01.2025 "Mbi miratimin e dhënies së mandatit të Zj.Leze Ndrek Kolaj, përfaqësuese e subjekti zgjedhor Partisë Socialdemokrate, pas krijimit të vakancës nga Këshilltari Zj.Klodisa Ded Qeleshi, përfaqesuese e subjekti zgjedhor Partia Socialdemokratike".***

Prefekti u njoh, por ky akt nuk përfshihet në kategorinë e akteve normative për të cilat Prefekti në zbatim të nenit 8, shkronja "a" e ligjit "Për Prefektin" i ndryshuar, ka detyrim të shprehet.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**PREFEKTI**

**Majlinda ANGONI**

Adresa: "Rruga 28 Nëntori" Shkodër, Telefon/Faks 00355 2224 2705, e-mail: Prefekti.Shkoder@mb.gov.al